




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Rregullores (QRK)- NR. 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme, udhëzuesit për zbatimin e Rregullores, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT KOMUNAL PËR KTHIM

Neni 1
Përbërja

Me këtë Vendim formohet Komisioni komunal për kthim, në përbërje:

1. Zoran Stojanovic, ZKKK - kryesuesë
2. Brahim Duriqi, Drejtorati për Arsim, anëtarë
3. Rozeta Selimi, DSHPS, anëtare
4. Lorik Bërbatovci, Zyrtar në QPS, anëtar
5. Rafete Retkoceri, DSHP, anëtare
6. Hana Berisha, DPUMM, anëtare
7. Ilir Shala, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, anëtarë
8. Miodrag Djekic, MKK-ja, anëtarë

Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit komunal për kthim

Komisioni komunal për kthim do të kryejë detyrat në bazë të dispozitave të Rregullores (QRK) – NR. 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme si dhe udhëzuesit për zbatimin e Rregullores.
Mandati i Komisionit është 3 vjeçar me mundësi vazhdimi edhe për një mandatë shtesë.

Neni 3
Hyrja në fuqi

- 1.Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohen kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.
- 2.Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi 1Nr.020/04-16922 i datës 30.03.2022

1Nr.020/04-16922/2
Lipjan, më 08.04.2022

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

